

UDHËZIM
Nr. 8, datë 9.8.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 30.1.2006 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.4, datë 30.1.2006 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” bëhen ndryshimet si vijon:

1. Fjalja e parë e paragrafit të parë të shkronjës “a” të pikës 2 riformulohet:

Përbërja e pagës bruto për efekt të llogaritjes së kontributeve përcaktohet në pikën 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.771, datë 13.11.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Paga bruto minimale dhe maksimale, për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar”. Në kuptimin e këtij vendimi, paga minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve do të zbatohet vetëm për personat fizikë (të vetëpunësuar) për veten e vet, ortakun që punon, si dhe për punonjësit e papaguar të familjes mbi 16 vjeç me të cilët punon e bashkëjeton, kurse për personat e punësuar (punëmarrës), te personat juridikë ose te personat fizikë, paga minimale për efekt të llogaritjes së kontributeve do të jetë ajo e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Asnjë punëdhënës, person juridik ose person fizik, me punëmarrësit e vet, nuk mund të lidhë marrëveshje kolektive ose kontratë individuale me pagë më të ulët se paga minimale e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.245, datë 27.4.2006.

Paga maksimale mujore për efekt të llogaritjes së kontributeve do të jetë ajo e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2005.

2. Në fjalinë e dytë të paragrafit të parë të shkronjës “b” të pikës 2, fjalët:

“Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001”, të zëvendësohen me: “Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006”.

3. Në fjalinë e parë të paragrafit të parë të shkronjës “c” të pikës 2, fjalët:

“Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.402, datë 11.6.2001, i ndryshuar”, të zëvendësohen me: “Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006, i ndryshuar”.

4. Të dhënat e pasqyrës në shkronjën “d” të pikës 8 ndryshohen si vijon:

Nr.	Dega e sigurimit shoqëror të:	Kontributet në përqindje			
		Për punëmarrësit			Personi fizik (i vetëpunësuar) për veten e vet dhe për punonjësit e papaguar të familjes
		Gjithsej	Pjesa e punëdhënësit	Nga paga e punëmarrësit	
1	Sëmundjeve (paafësi e përkohshme)	0.80			0.00
2	Barrë lindjeve	2.30			2.30
3	Pensione	23.90			23.90
4	Aksidente dhe sëmundjeve profesionale	0.50	0.50	0.00	0.00
5	Papunësi	2.00	2.00	0.00	0.00
6	Shuma sigurim shoqëror	29.50	20.00	9.50	26.20
	Shuma sigurim shëndetësor	3.40	1.70	1.70	7.00
	TOTALI	32.90	21.70	11.20	33.20

5. Në pikën 8, shkronja “e” riformulohet:

e) Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.167, datë 29.3.2006 “Për disa çështje në zbatim të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit janë të detyruar të paguajnë kontributet dhe të sigurojnë punëmarrësit, si dhe i vetëpunësuarit për vete dhe punonjësit e papaguar të familjes së tij, në degët e sigurimit si më poshtë:

- Të punësuarit, me ose pa kontratë, të një person juridik ose person fizik, në cilësinë e punëdhënësit siç janë:

a) personat juridikë publikë që financohen vete ose nga Buxheti i Shtetit, si dhe entet e tjera publike të njohura nga ligji si person juridik;

b) personat juridikë privatë, si shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat. Kur pronarët e personave juridikë ushtrojnë funksione drejtuese në shoqëri si administratorë, apo çdo funksion tjetër trajtohen si çdo punëmarrës tjetër.

c) personat fizikë (të vetëpunësuar) që punësojnë persona të tjerë.

Të punësuarit si më sipër, që punojnë pa afat ose me afat më shumë se një muaj, me kohë të plotë ose të pjesshme pune, për më shumë se 24 orë në javë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për paafësi të përkohshme në punë, për barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale, papunësinë dhe sigurim shëndetësor.

- Të punësuarit me kontratë pune me ose pa afat por me kohë të pjesshme pune që zgjat më pak se 24 orë në javë, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme në nivel minimal, për barrë lindje, pensione, aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor.

- Të punësuarit me kontratë pune me afat më pak se një javë gjatë vitit, me kohë të plotë ose të pjesshme pune, të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme për aksidente në punë e sëmundje profesionale dhe sigurim shëndetësor.

- Personat e vetëpunësuar (persona fizikë, të tillë si: i vetëpunësuar i vetëm, i vetëpunësuar me punëmarrës, i vetëpunësuar me punëmarrës dhe punonjës të papaguar të familjes, i vetëpunësuar pa punëmarrës me punonjës të papaguar të familjes), që ushtrojnë veprimtari ekonomike pavarësisht

nga kohëzgjatja e saj, të cilët për vete sigurohen në mënyrë të detyrueshme për barrëlindje, pensione dhe sigurim shëndetësor.

- Punonjësit e papaguar të familjes, që punojnë e bashkëjetojnë me personin fizik (të vetëpunësuarin), të cilët sigurohen në mënyrë të detyrueshme në nivel minimal, për barrëlindje, pensione dhe sigurim shëndetësor.

- Personat me të ardhura të rregullta nga pronësia, mbi 16 vjeç, paguajnë vetëm për sigurimin shëndetësor.

- Kursantët dhe studentët, për kohën e praktikës mësimore, sigurohen nga punëdhënësi, vetëm për aksidentet në punë.

- Shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët kanë një marrëdhënie punësimi të çfarëdo forme, apo ushtrojnë një aktivitet ekonomik në Republikën e Shqipërisë, janë të detyruar të kontribuojnë në skemën e sigurimeve shoqërore, pra të paguajnë rregullisht kontributet.

Në këtë kuptim, përfitojnë mbrojtjen nga sigurimet shoqërore dhe ndërkohë kanë detyrimin për të paguar kontribute edhe shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, që punojnë si punëdhënës, të vetëpunësuar ose si punëmarrës në subjekte që janë të regjistruara ose kanë detyrim për regjistrim në organet tatimore të Shqipërisë.

Përjashtohen nga detyrimi për të paguar kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore:

- a) shtetasit e huaj që punojnë në subjekte, të cilat mbi bazën e një marrëveshjeje qeveritare, nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar, për kontributet, në organet tatimore shqiptare.

- b) shtetasit e huaj, pjestarë të subjekteve punëdhënëse të huaja, të cilat nuk kanë detyrimin për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare. Këtu përfshihen shtetasit e huaj që vijnë të punojnë në Shqipëri, për një punë të caktuar, mbi bazën e një kontrate ligjore punësimi apo shërbimi të lidhur midis punëdhënësit të tyre (i cili nuk ka detyrim për t'u regjistruar në organet tatimore shqiptare) dhe subjektit të regjistruar në organet tatimore shqiptare. Sipas përcaktimit që duhet të jetë vendosur në kontratë dhe në zbatim, këtyre shtetasve të huaj paga nuk i jepet nga subjekti i regjistruar në organet tatimore shqiptare, por i transferohet zyrtarisht punëdhënësit të tij nga është dërguar.

6. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode